VENDIM
Nr. 275, datë 4.5.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS 'TASI DËMA', FIER"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i rrugës 'Tasi Dëma', Fier".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Fier.
3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 3 052 210 (tre milionë e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind e dhjetë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 052 210 (tre milionë e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind e dhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Fier.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Fier.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare" dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Fier.
8. Bashkia Fier kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Fier.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Fier për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Fier për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.
12. Ngarkohen Bashkia Fier, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E BASHKËPRONARËVE TË PASURISË TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS 'TASI DËMA', FIER"

Nr.	Pronari	Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Të dhënat për shpronësim				Shënime
Nr.	**Emër Mbiemër**	**Zona kadastrale**	**Nr. i pasurisë**	**Lloji i pasurisë**	**Sip. e truallit (m^2) gjithsej**	**Sip. e truallit që shpronësohet (m^2)**	**Çmimi i truallit (m^2)**	**Vlera e truallit (lek)**	**Vlera totale**	**Konfirmimi ASHK Fier**
1	Artan Isufaj, Rubin Isufaj, Sokol Isufaj, Kimete Isufaj	8531	13/484	Truall	819	245	12458	3,052,210	3,052,210	Konfirmuar nga ASHK-ja Me certifikatë pronësie
Vlera totale									**3,052,210**	